



**CSF** TIRANA  
2023

# Rekomandimet Kyçe

të Grupit Tematik Punues për  
Klimën dhe Agjendën e Gjelbër

Shqip

**OPEN SOCIETY**  
FOUNDATIONS  
WESTERN BALKANS

 **Cooperation & Development Institute**  
Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

 **ΕΛΙΑΜΕΠ**  
**ELIAMEP**  
ΕΛΛΗΝΙΚΟ ΙΔΡΥΜΑ ΕΥΡΩΠΑΪΚΗΣ & ΕΞΩΤΕΡΙΚΗΣ ΠΟΛΙΤΙΚΗΣ  
HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN & FOREIGN POLICY

**IPECC** 

#CSFTirana2023

# ZHBLOKIMI I PROGRESIT

E ardhmja Evropiane e Ballkanit  
Perëndimor

**E udhëhequr nga:**

**Instituti për Qeverisje të Mirë dhe Politika në Mjedisin Jetësor dhe  
Ndryshime Klimatike  
(IPECC) (Maqedonia e Veriut)**

**Autorët:**

Toni Popovski dhe Jadranka Ivanova

**Bashkëpunëtorët:**

Radica Koceva, Ermelinda Mahmutaj, Ivana Vojinoviç dhe Ornella Cuci

**Recenzent:**

Isabel Joannides

## Rreth Procesit

Ky Dokument për politikën është përgatitur nga Instituti për Qeverisje të Mirë dhe Politika në Mjedisin Jetësor dhe Ndryshime Klimatike (IPECC) si drejtues i Grupit Tematik të Punës (GTP) për Klimën dhe Agjendën e Gjelbër të Forumit të Shoqërisë Civile dhe Forumit Think Tank për vitin 2023 (CSF2023) ) të Procesit të Berlinit. Qëndrimet e listuara në Dokumentin e Politikave u formësuan përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultimi, duke përfshirë përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, anëtarë të GTP për Klimën dhe Agjendën e Gjelbër dhe palët e interesuara nga 6 vende nga Ballkani Perëndimor (BP6), ekspertë të shquar nga BP6 dhe Bashkimi Evropian (BE), si dhe përmes hulumtimit të punës të paraqitura në Dokumentet Hyrëse dhe njohuritë e fituara përmes takimeve dhe përfaqësimeve. Prosesi përfshin tre takime konsultative në të cilën ishin përfshirë 266 palë të interesuara dhe konferencë hibride publike ku morën pjesë 102 pjesëmarrës. Këto rekomandime janë rezultat i një përpjekjeje të fokusuar dhe gjithëpërfshirëse të Grupit Tematik të Punës për Klimën dhe Agjendën e Gjelbër.

Konsultimet e këtij viti u fokusuan në temën “Investime në Infrastrukturën e Gjelbër”, duke e theksuar rëndësinë e: “Qeverisjes së Mirë në Mjedisin Jetësor” dhe “Biodiversitetit dhe Mbrojtjes së Burimeve Natyrore”. Në këtë dokument, “Investime në Infrastrukturën e Gjelbër” mbulon investimet e projekteve që synojnë reduktimin e ndotjes, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbetjeve, transportin e qëndrueshëm dhe rritjen e zgjidhjeve natyrore<sup>1</sup>. Sfidat kryesore dhe aktivitetet e nevojshme në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) u hartuan bashkërisht, u analizuan dhe u lidhën me rekomandime për t’i zgjidhur ato në mënyrë efikase dhe efektive. Këto rekomandime do t’u paraqiten udhëheqësve të Bashkimit Evropian (BE) dhe BP6 gjatë Samitit të Procesit të Berlinit 2023 që do të mbahet në Tetor 2023 në Tiranë.

<sup>1</sup> Siç përcaktohet në dokumentin e Komunikimit të KE 52013DC0249  
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A52013DC0249>

## KONTEKSTI I POLITIKËS SË BE-SË DHE BALLKANIT PERËNDIMOR PËR KLIMËN DHE AGJENDËN E GJELBËR

Rekomandimet e formuluar janë të lidhura ngushtë, dhe kontribuojnë në arritjen, e objektivave kryesore të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, e cila mbështetet në reformat rregullatore në rajon për t'i përafuar ato me objektivat e Marrëveshjes së Gjellbër Europiane, si dhe investimet përkatëse që janë pjesë e Planit Ekonomik dhe Investiv për Ballkanin Perëndimor (PEI), të zbatuara nëpërmjet mekanizmit të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP). Agjenda e Gjellbër për BP6 konsiderohet si një shtytës kryesor i tranzicionit drejt një ekonomie moderne, neutrale ndaj karbonit, rezistente ndaj klimës dhe me ekonomi me burime efikase të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe rajonit.

Gjatë përgatitjes së Dokumentit për Politika dhe rekomandimeve të tij përbërëse, u shqyrtuan njohuri nga Raportet e rregullta Vjetore të publikuara nga Komisioni Evropian mbi progresin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e anëtarësimit në BE dhe përfaqësonin një mjet kyç për monitorimin e përputhshmërisë së vendeve kandidate me standardet dhe vlerat e BE-së. Gjithashtu u morën parasysh metodologjitë e reja për negociatat e anëtarësimit që filluan në vitin 2020, duke u fokusuar në kapitujt përkatës të negociatave: Kapitulli 22 – Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore në Klasterin 5 – Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni, dhe Kapitulli 27 – Mjedisi Jetësor dhe Ndryshimet Klimatike në Klasterin 4 – Agjenda e Gjellbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme.

Raportet e fundit të Komisionit Evropian për të gjitha vendet e BP6 theksuan se, për sa i përket Kapitullit 27, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë arritur një nivel të caktuar gatishmërie, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina (BiH) dhe Kosova janë në një fazë të hershme të gatishmërisë. Nga ana tjetër sa i përket Kapitullit 22, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë në nivel mesatar të gatishmërisë, ndërsa BiH dhe Kosova janë në një fazë të hershme gatishmërie.

## ARRITJA E LEGJISLACIONIT TË PARASHIKUAR NGA AGJENDA E GJELBËR

Agjenda e Gjellbër është shtylla kryesore në përpjekjet e BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht pasi drejton procesin kompleks të integritimit në BE. Ajo reflektohet në klaseret negociuese të kapitujve të BE-së, që mbulojnë Politikën e Transportit (Kapitulli 14), Energjinë (Kapitulli 15), Rrjetin Trans-Evropian (Kapitulli 21) dhe Mjedisin Jetësor dhe Ndryshimet Klimatike (Kapitulli 27). Përvoja e disa prej Shteteve më të reja Anëtare të BE-së ka dëshmuar se implementimi i Kapitullit 27 përfaqëson një nga aspektet financiarisht më komplekse të procesit të anëtarësimit; përmbushja e kërkesave të këtij segmenti të legjislacionit kërkon burime të konsiderueshme financiare për zhvillimin e infrastrukturës kritike, veçanërisht në fushën e menaxhimit të ujërave dhe mbetjeve. Përveç kësaj, arritja e neutralitetit të klimës kërkon fonde shtesë në sektorin privat, i cili do të duhet të përfshijë parimet e Mjedisit Jetësor, Sociale dhe të Qeverisjes (ESG) në politikat dhe praktikat e tyre të korporative, si dhe të reduktojë emetimet e tyre. Investimet në ruajtjen e biodiversitetit janë kyçe për arritjen e neutralitetit klimatik; për këtë arsye, ministrat e BE-së kërkuar një pjesë të konsiderueshme, gjegjësisht 30% e buxhetit të BE-së dhe shpenzimeve të BE-së për Gjeneratën e Ardhëshme që do të kenë synim të merren me ndryshimet klimatike, të investohen në biodiversitet dhe në zgjidhje të bazuara në natyrë për ruajtjen e diversitetit biologjik.<sup>2</sup>

Disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë një vlerësim të nevojave për investime në lidhje me Kapitullin 27, në tërësi ose për komponentë të veçantë të legjislacionit, gjë që tregon shpenzime të konsiderueshme për zbatimin. Serbia vlerësoi një nevojë prej 12 miliardë Eurosh (nga viti 2021)<sup>3</sup> për të përmbushur kërkesat e Kapitullit 27, ndërsa nevojat e Malit të Zi për zbatimin e Planit Akcionar për të arritur standardet e Kapitullit 27, që mbulon periudhën mes viteve 2021 – 2025, vlerësohet në rreth 483 milionë euro.<sup>4</sup> Në vitin 2017, Maqedonia e Veriut vlerësoi një nevojë prej 1.2 miliardë Eurosh për zbatimin e Direktivave të BE-së në lidhje me Ujërat e Zeza Urbane dhe Ujin e Pijshëm.<sup>5</sup> Nevojat financiare për zbatimin e Direktivave të njëjta nga ana e Shqipërisë arrijnë në 3.5 miliardë euro.<sup>6</sup>

Zbulimet e Komisionit Evropian të deklaruara në Raportet Vjetore të Progresit për vitin 2022 tregojnë se BP6 kanë kapacitete të dobëta dhe të kufizuara administrative, një nivel mesatar një i përputhjes me legjislacionin e BE-së, si dhe janë në fazat e hershme të zbatimit të legjislacionit që i referohet mjedisit jetësor. Legjislacioni i gjerë i BE-së për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike, i cili më shumë përshpejtim zgjerohet me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së, rrit më tej

<sup>2</sup> <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-11829-2020-INIT/en/pdf>

<sup>3</sup> Deklarata e Sekretarit shtetëror të Ministrisë së Mbrojtjes të Mjedisit jetësor të Serbisë dhënë gjatë aktivitetit të Dialogut të Liderëve - "Zbatimi i Agjendës së Gjellbër për Prosperitetin Ekonomik dhe Social në Ballkanin Perëndimor" mbajtur më 6-7 qershor 2023 në Tiranë

<sup>4</sup> <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Montenegro%20Report%202022.pdf>

<sup>5</sup> Projekti IPA: Zhvillimi i një studimi nacional për ujërat, EuropeAid/136505/IH/SER/MK (2017)

<sup>6</sup> Projekti i financuar nga SIDA, Negociatat e Ujërave dhe Mbështetja e Planifikimit të Investimeve, Shqipëri (2023)

vonesën e reformave të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo situatë rrit nevojën për burime financiare shtesë për të zbutur presionin mbi buxhetet nacionale gjatë gjithë periudhës së antarsimit në BE. Zgjidhja i këtij dispariteti kërkon investime të konsiderueshme dhe të shpejta në sektorin e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike.

Mungesa e fondeve në dispozicion për financimin e infrastrukturës së gjelbër është një sfidë kryesore me të cilën përballen BP6. Sfida rritet më tej nga kapaciteti i pamjaftueshëm dhe i dobët administrativ për përdorimin efektiv të fondeve tashmë të siguruar nga BE-së, duke shtuar një shtresë tjetër të kompleksitetit në situatën aktuale të vështirë që buron nga nevoja për më shumë mjete financiare.

Angazhimi i BE-së për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe investimet e rëndësishme përmes Planit Ekonomik dhe Investimeve (PEI), nënvizojnë rëndësinë e qeverisjes së mirë mjedisore. Në të njëjtën kohë, ai përfaqëson një mundësi unike për të përshpejtuar tranzicionin e rajonit drejt ekonomive më të gjelbra. Kapitujt 22 dhe 27 luajnë një rol kyç në përpjekjet e BP6 drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm. Zbatimi i këtyre kapitujve kërkon kapacitet të konsiderueshëm administrativ dhe planifikim strategjik.

Korniza ekzistuese e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA), megjithëse ofron një bazë solide për ndërtimin e kapaciteteve të vendeve për të planifikuar dhe menaxhuar fondet e BE-së dhe implementimin e Legjislacionit të BE-së ka treguar kufizimet e tij në drejtim të arritjes së rezultateve të dëshiruara. Për këtë arsye, vendet e Ballkanit Perëndimor kërkojnë një rritje të mekanizmave inovative të bazuar në parimin e solidaritetit, duke përfshirë kornizën logjike dhe operative të Fondeve të Kohezionit. Është me rëndësi thelbësore që BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor të gjejnë më në fund një mënyrë për të zbatuar në mënyrë efektive në praktikë parimin bazë të IPA-së, i cili synon t'i pajisë vendet e para-anëtarësimit me aftësitë e nevojshme për të menaxhuar fondet e BE-së pas anëtarësimit. Prandaj, vendeve duhet t'u jepen mundësi të konsiderueshme për të fituar përvojën e nevojshme në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Faktorët e sipërpërmendur theksojnë nevojën për një ndryshim paradigme, e cila përfshin hartimin e mbështetjes së financimit të BE-së si dhe ri-konfigurimin e strukturës së saj të menaxhimit dhe praktikave operative. Ndryshimi duhet të marrë parasysh aspiratën e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, nevojën për të krijuar një sistem efektiv të orientuar drejt rezultateve në vend të korrektësisë politike, bazuar në parimin e niveleve të shumëfishta të qeverisjes, duke përfshirë autoritetet rajonale, lokale dhe autoritetet e tjera publike, duke përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat.

# REKOMANDIME

## I – Përmirësimi i investimeve në infrastrukturën e gjelbër në vendet e Ballkanit Perëndimor

1. **Bashkimi Evropian (BE) duhet të risë më tej mbështetjen e tij për vendet e Ballkanit Perëndimor duke krijuar një mekanizëm financimi të ndërtuar mbi solidaritetin dhe me akses në nivele të shumta të qeverisjes.** Qëllimi kryesorë i këtij mekanizmi duhet t'i adresohet nevojave financiare të vendeve të Ballkanit Perëndimor me qëllim arritjen e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së dhe kalimin në një shoqëri neutrale ndaj karbonit. Megjithëse IPA ofron një fond solid për zhvillimin e instrumentit i cili është afër objektivave dhe logjikës operationale e Fondeve të Kohezionit të BE-së, megjithatë ai shfaq disa kufizime në përshpejtim të integritit në BP6 dhe përmbushja e standardeve të BE-së. Komisioni Evropian duhet të propozojë masa ligjore për përshtatjen dhe miratimin e mëtejshëm të këtij mekanizmi financues, duke siguruar shtrirjen e saj njëkohësisht me Politikën kohezuese të BE-së pas vitit 2027 dhe me efektivitetin e saj, në kornizën financiare shumë vjeçare të BE-së mes viteve 2028 – 2035. Është gjithashtu thelbësore që mekanizmi të përfshijë pjesëmarrjen aktive të autoriteteve publike rajonale dhe lokale, shoqërisë civile dhe sektorit privat, duke krijuar kështu një ndjenjë të fortë pronësie midis palëve të interesuara. Për më tepër, **BE-ja duhet të sigurojë që programimi dhe menaxhimi i mekanizmit të financimit të bazohet në përfshirje dhe transparencë** gjatë gjithë ciklit jetësor të projekteve, nga planifikimi fillestar deri në zbatimin e tyre. Transparenca e inkurajon përfshirjen, rrit përgjegjshmërinë dhe ndihmon në zbutjen e sfidave që dalin nga burokracia, kufizimet e kapaciteteve dhe rastet e mundshme të korrupsionit.



**2. BE-ja, vendet e Ballkanit Perëndimor, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiare duhet të punojnë së bashku për të krijuar një "Qendër Rajonale të BP6 të fokusuar në Projektet Infrastrukturore"** me qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal përmes planifikimit dhe promovimit të përbashkët të zbatimit të projekteve të infrastrukturës së gjelbër, si dhe tërheqjen dhe bashkimin e profesionistëve të aftë dhe me përvojë nga rajoni, të cilët zotërojnë ekspertizën dhe aftësitë e nevojshme. Rezultatet e pritshme do të përfshijnë mobilizimin dhe thithjen e përshtetshme të fondeve evropiane, dypalëshe, shumëpalëshe dhe fondeve nacionale, duke promovuar sinergji dhe shmangia e dyfishimit të përpjekjeve. Kapacitetet ekzistuese, si ato të Sekretariatit të Komunitetit të Transportit, duhet të përdoren për të identifikuar dhe promovuar projekte në sektorin e transportit, për shembull, me ndikim rajonal.

**3. BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ofrojnë mbështetje të mjaftueshme financiare dhe administrative për sektorin privat në rajon, duke i inkurajuar ata të bëjnë përpjekje të vazhdueshme drejt një ekonomie blu dhe të gjelbër/rrethore.** Kjo përfshin menaxhimin e mbetjeve, riciklimit, prodhimin të qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve, si dhe ndihmën për sistemin bankar komercial në vendet e Ballkanit Perëndimor për përputhshërinë e shërbimeve financiare me kërkesat e mjedisit jetësor të BE-së.

## II - Përforcimi i qeverisjes së mirë në mjedisin jetësor dhe klimë, si një element thelbësor për zbatimin e Agjendës së Gjelbër

4. **Kryeministrat, Ministrat e Financave dhe Ministrat e Mjedisit Jetësor në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ndërmarrin veprime të shpejta për të forcuar kapacitetet e autoriteteve nacionale dhe të vetëqeverisjeve lokale të cilët kanë përgjegjësi në mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.** Këto aktivitete duhet të shoqërohen me përpjekje të fokusuara për të forcuar efektivitetin në programim dhe menaxhim me mjetet e donuara, veçanërisht, duke theksuar Kapitujt 22 dhe 27 dhe zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Një kohsisht, duhet të formulohen dhe zbatohen politika të forta të mbajtjes së stafit.

5. **Procesi i forcimit të kapaciteteve administrative duhet të përshpejtohet, duke marrë parasysh urgjencën e çështjes.** Kështu, vendet e Ballkanit Perëndimor do të jenë në një pozicion më të mirë për t'u përballur me kompleksitetin e harmonizimit me kërkesat e mjedisit jetësor dhe arritjes së neutralitetit klimatik, dhe në përputhje me qëllimet e procesit të integritimit në BE dhe Agjendës së Gjelbër. Strukturat administrative nacionale dhe vendore duhet të mbulohen në mënyrë të barabartë me mbështetje të vazhdueshme teknike dhe financiare. Organizatat civile mund të kenë një rol të rëndësishëm në përmbuthjen e nevojave të caktuara në aspektin e kapaciteteve, dhe duke u dhënë mbështetje vendeve të Ballkanit Perëndimor në zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin jetësor dhe klimën, si dhe arritjen e neutralitetit klimatik.

### III - Rritja e investimeve në biodiversitet dhe në mbrojtjen e burimeve natyrore, të cilat janë më të rëndësishmet për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

**6. Udhëheqësit e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të ndërmarrin masa vendimtare për të siguruar financim të qëndrueshëm kushtuar ruajtjes dhe restaurimit të burimeve të paçmuara natyrore të rajonit.** Mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve është e një rëndësie thelbësore për arritjen e neutralitetit klimatik në vendet e Ballkanit Perëndimor, prandaj financimi për mbrojtjen e diversitetit biologjik duhet të rritet gradualisht në mënyrë që të arrijë në 30% të buxhetit të përgjithshëm nacional të caktuar për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe klimës në pesë vitet e ardhshme. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të miratojnë menjëherë legjislacionin për integrimin e klimës të buxheteve nacionale.

**7. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të harmonizojnë në mënyrë proaktive politikat e tyre me "Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin për vitin 2030 - Rikthimi i Natyrës në Jetën Tonë".** Në qendër të këtij harmonizimi qëndron zbatimi i masave për arritjen e synimeve për krijimin e një rrjeti koherent të zonave të mbrojtura të mirë menaxhuara dhe mbrojtjen e të paktën 30% të sipërfaqes tokësore të Ballkanit Perëndimor dhe 30% të sipërfaqes ujore (dete), pra një e treta që është ose duhet të mbrohen rreptësisht. Kjo përfaqëson 10% të tokës dhe 10% të detërave në Ballkanin Perëndimor.

8. **BE-ja duhet të siguroj te pakten 30% të burimeve e saja financiare të lidhura me klimën për vendet e Ballkanit Perëndimor të investohen në biodiversitet dhe në zgjidhje të bazuara në natyrë.** Këto zgjidhje janë thelbësore për t'u kujdesur për biodiversitetin dhe fondet duhet të drejtohen drejt përmirësimit të efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura, sigurimit të përputhshmërisë me strategjitë dhe kërkesat e BE-së në lidhje me Natura 2000, dhe stimulimin e autoriteteve lokale dhe banorëve për të menaxhuar zonat rurale përmes zbatimit të bizneseve të gjelbra, me synim ndalimin e urbanizimit të mëtejshëm dhe emigrimit nga zonat rurale. Fondet gjithashtu duhet të ndahen për mbrojtjen e specieve të rrezikuara dhe menaxhimin e klasterëve ndërkufitare të zonave të mbrojtura dhe korridoreve të gjelbra, duke siguruar lidhje afatgjatë ekologjike në rajon dhe krijimin e partneriteteve midis autoriteteve të ndryshme përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës dhe zonave të mbrojtura, institucione shkencore dhe organizata të shoqërisë civile nga rajoni.